



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T
të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
22.09.2014, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Kryetar i Komunës, Shpend Ahmeti, Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, Hazir Borovci, Ylli Hoxha, Hatixhe Hoxha, Islam Pacolli, dhe Imer Rusinovci.

Mungoi : Cuneyd Ustaibo.

Morën pjesë edhe: Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, Liburn Aliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe dy përfaqësues nga drejtoria e Urbanizmit, Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, përfaqësuesi i Kompanisë "Urban Plus", Ilirë Gjinolli dhe përfaqësuesi i OSBE-së.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Para se të fillonin me diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, Kryesuesi propozoi që pika e 8 e rendit të ditës **Propozim vendimi për lënien në diskutim publik të vendimit për ndryshim dhe plotësim të Planit rregullues "Arbëria 3"**, të diskutohet si pikë e parë.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës i përshëndeti te pranishmit, njëherit duke e prezentuar Njomza Rexhepaj si këshilltare të kabinetit të Kryetarit dhe Xhevdet Pozhari ndihmës në mënyrë vullnetare në Zyrën për marrdhënie me media.

Ylli Hoxha theksoi që për rend dite për Kuvend të jenë edhe pikat: Dhënia e betimit të anëtarëve të rinj të Kuvendit dhe zëvendësimi i tyre në komitete obligative dhe në komisionet e aksionarëve.

Për këtë mbledhje u propozua ky

REND DITE:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së pestë dhe të mbledhjes urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim buxheti për vitin 2015 dhe Korniza afatmesme buxhetore 2015 - 2017;
3. Propozim rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015;
4. Propozim vendimi për tarifat, ngarkesat dhe gjobat komunale për vitin 2015;
5. Propozim rregullorja për rendin e brendshëm në parkun e Gërmisë;
6. Krijimi i Ndërmarrjes publike lokale "Prishtina Parking", SH .A.;

7. Propozimi për emërimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës në Komisionin komunal të aksionarëve për NPL" Prishtina Parking" SH .A.;
8. Propozim vendimi për lënien në diskutim publik të vendimit për ndryshim dhe plotësim të Planit rregullues "Arbëria 3";
9. Informatë për suksesin e nxënësve, përfundimin e vitit shkollor 2013 - 2014 dhe fillimin e vitit shkollor 2014 - 2015;
10. Informatë për përfundimin e korrje – shirjeve dhe
11. Të ndryshme.

Pika e tetë

Përfaqësuesi i Kompanisë "Urban Plus", Ilirë Gjinolli bëri prezantimin në mënyrë elektronike për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues "Arbëria 3".

Sami Hamiti tha se, do ta trajtojnë pas diskutimit publikë se prapë do të vij në Këshillin e drejtorëve dhe në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Ai u interesua për vendimin e më hershëm për ndryshimin e disa rrugëve, duke shtuar se ai vendim a është marrë parasysh.

Liburn Aliu tha se janë bërë disa ndryshime të rrugëve dhe ceku se, problem më serioz kanë pasur për dy objekte që gjinden afër hekurudhës.

U konstatua se njëzëri u përkrahë Propozim vendimi për lënien në diskutim publik të vendimit për ndryshim dhe plotësim të Planit rregullues "Arbëria 3", dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e parë:

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe të mbledhjes urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë:

Lidhur me **Propozim buxhetin për vitin 2015 dhe Kornizën afatmesme buxhetore 2015-2017, Halim Halimi** tha se, Ministria e ka nxjerrë qarkoren për vitin 2015, ku ju është shpërndarë komunave, është përgatitur buxheti, janë mbajtur disa takime lidhur me këtë çështje.

Dardan Sejdiu dha sqarime lidhur me buxhetin për vitin 2015 dhe Kornizën afatmesme buxhetore 2015 - 2017.

Visar Berisha tha se sa i përket buxhetit janë kryer të gjitha proceset, diskutimet publike dhe konsultimet në mes të drejtorive. Sa i përket procesit do t'i fusim të gjitha sugjerimet e marra në buxhet nga takimet dhe do t'i dërgojnë në Kuvend.

Sami Hamiti shprehu mendimin se vërejtje e vetme për buxhetin është të rishikohen grandet që projektet e parapara nga grandet të realizohen e mos të na merren nga Qeveria.

Yll Hoxha tha se, shpreson se do të ketë rritje të buxhetit edhe krijimi i parkingut do të sjell mjete.

Ai sugjeroi që të futet në buxhet këto çështje:

Funksionaliteti për transmetimin e drejtpërdrejt të seancave;
Për marrëdhënie me publikun të ndahet shumë më e madhe e mjeteve;
Për përfaqësime juridike të Komunës të ndahen më shumë mjete për ndonjë kompani për të mbrojtur Komunën (në konteste eventuale);
Çështja e BL - ve , ku shumica e banesave nuk kanë këshilla të banesave, andaj duhet të ndahen mjete për intervenim për rregullimin e ashensorëve ose funksionalizimin e këshillave të banesave;
Mundësinë e largimit të shpenzimeve për uniforma nëpër shkolla;
Trajtimi i komunitetit romë në aspektin e shkollimit;
Furnizimin e fëmijëve në shkolla të mesme, për raste sociale, me libra dhe transport.
Si GP e përkrahim këtë propozimbuxhet.

Islam Pacolli tha se duhet ti jepet përparësi infrastrukturës sidomos kanalizimit. Bashkësitë lokale kanë ekzistuar por nuk kanë pasur kushte të mira për shërbim të qytetarëve.

Shtëpitë e kulturës, bibliotekat, të pajisen më mirë, sidomos ajo e fshatit Hajvali. E përkrahim këtë propozim buxhetin për vitin 2015 dhe Kornizën afatmesme buxhetore 2015 - 2017.

Imer Rusinovci theksoi se edhe ne e përkrahim propozim buxhetin, ndërsa sa i përket subvencioneve të dedikuara për bujqësi janë rritë, por të shikohet mundësia që ato të rriten edhe më shumë.

Hazir Borovci shprehu mendim që të kërkohet sa më parë të bëhet Ligji për Prishtinën, për një jetë më cilësore për qytetarët e Prishtinës.

Sa i përket bujqësisë konsideron se shumica e caktuar për bujqësi është e vogël. Ai sugjeroi që të jepen leje të ndërtimit.

Po ashtu tha se e përkrahin Propozim buxhetin për vitin 2015 dhe Kornizën afatmesme buxhetore 2015 - 2017.

Dardan Sejdiu dha sqarime lidhur me diskutimet e parafolësve, ku tha se janë 5486 parkingje në rrethin e Prishtinës, të cilat ose nuk përdoren ose përdoren pa pagesë, ku prej tyre 1300 vende i kanë hequr.

Sa i përket menaxhimit me media, do ta kemi një zyrtare në zyre për media, e cila është në proces e sipër. Sa i përket Zyres së përfaqësimeve ligjore, ajo është kompletuar me staf.

Sa i përket uniformave, është mirë të mendohet për shkollat e mesme, pasi që kemi një numër të vogël të shkollave.

Sa i përket furnizimit të fëmijëve me libra dhe transportit në shkolla të mesme, do të fillojmë me listat që do të na vijnë për fëmijët me raste sociale.

Ndërsa për lejet e ndërtimit kemi nevojë me qenë më transparent.

U konstatua se njëzëri u përkrahë Propozim buxheti për vitin 2015 dhe Korniza afatmesme buxhetore 2015 - 2017 dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë:

Lidhur me Propozim rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015, **Yll Hoxha** tha se kur kemi të bëjmë me familjarët e dëshmorëve, nuk parashihet lirimi i kategorive të luftës, lirimi i anëtarëve të dëshmorëve.

Agim Salihu dha sqarime lidhur me këtë çështje.

U konstatua se njëzëri u përkrahë Propozim rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015 dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt:

Sa i përket Propozim vendimit për tarifën, ngarkesat dhe gjobat komunale për vitin 2015, Dardan Sejdiu tha se në Kuvend një pjesë e këtij vendimi është miratuar, ndërsa pjesa tjetër është refuzuar.

Sa i përket nenit 2, paragrafi 6, nën paragrafi 6.15 dhe 6.16 po ashtu 6.23 nuk janë ngritje të mëdha, andaj në Kuvend ta diskutojmë dhe ta miratojmë.

Sami Hamiti tha se kjo shumë është e stër ngarkuar, andaj të marrim sa është norma, rrethi.

Yll Hoxha tha se e përkrahim këtë ndryshim të rregullores dhe se nuk janë çmimet e larta.

U konstatua se njëzëri u përkrahë Propozim vendimi për tarifën, ngarkesat dhe gjobat komunale për vitin 2015 dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë:

Lidhur me Propozim rregulloren për rendin e brendshëm në parkun e Gërmisë, **Agim Salihu** tha se neni 24 paragrafi 4 të bartet te neni 23 me tekstin. Po ashtu në nenin 45 te paragrafi 1 te futet dhe fjala "ndërmarrja".

Yll Hoxha tha sa i përket mbrojtjes së ambientit, ka vërejtje se lokalet që janë duke punuar në parkun e Gërmisë po e ndotin ajrin.

Po ashtu ceku çështjen e parkingut të makinave në park, si dhe çështjen e inkasimit, për të cilin ishte i mendimit që kjo formë të automatizohet.

Po ashtu tha se në rrugën e Gërmisë ka pasur në kohë të shkurtë shumë viktime nga shpejtësia e madhe e automjeteve, andaj të vihen kamerat në atë rrugë dhe të gjobiten kryesit e veprave.

Rreth çështjes parkingjeve, **Agim Salihu** dha sqarime shitesë.

U konstatua se njëzëri u përkrahë Propozim rregullorja për rendin e brendshëm në parkun e Gërmisë dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë:

Lidhur me krijimin e Ndërmarrjes publike lokale "Prishtina Parking". **SH. A, Dardan Sejdiu** dha sqarime lidhur me themelimin e kësaj ndërmarrjeje.

U konstatua se njëzëri u përkrahë krijimi i Ndërmarrjes publike lokale "Prishtina Parking", SH .A dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë:

Lidhur me Propozimin për emërimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës në Komisionin komunal të aksionarëve për NPL "Prishtina Parking", SH .A; Agim Salihu tha se në Kuvend bëhet propozimi për emërimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës.

U konstatua se njëzëri u përkrahë Propozimi për emërimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës në Komisionin komunal të aksionarëve për NPL "Prishtina Parking", SH .A dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e nëntë:

U konstatua se njëzëri u përkrahë Informata për suksesin e nxënësve, përfundimin e vitit shkollor 2013 - 2014 dhe fillimin e vitit shkollor 2014 - 2015 dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim.

Pika e dhjetë:

U konstatua se njëzëri u përkrahë Informata për korrje - shirjet dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e njëmbëdhjetë:

Të ndryshme:

Kryesuesi **Halim Halimi** i njoftoi të pranishmit se në Komisionin komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Komunale "Trafiku Urban" duhet të bëhet zëvendësimi me anëtarët tjerë të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 18:00.

Procesmbajtësit:
Zijadin Gashi
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit:
Halim Halimi, jur.i dipl.